



|  |                               |                               |                               |
|--|-------------------------------|-------------------------------|-------------------------------|
| Pranuar / Dorezuar<br>Puniljenj/Prodato<br>Received/Delivery | 28.07.2022                    | 2                             | viti<br>god<br>year           |
| Organ /Njesia<br>Organ /Jednica<br>Org./Unit                 | Nr Prot<br>Br Prot<br>Prot No | Shtojca<br>Prilog<br>Appendix | Sasia<br>Kolicina<br>Quantity |
| SKANSKOCK  | 4392/2022                     |                               | 1/3.                          |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova -- Republic of Kosovo**

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA**  
**INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO**

A.nr.531/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi Bajraktari-kryetar, Jeton Koca dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Zyle Millaku Gojnovci -Zyrtare e lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.531/2022 të datës 14.06.2022 të parashtruar nga ankuesi me adresë, kundër organit të punësimit Shërbimi Korrektues i Kosovës, në çështjen juridike "Kompensim material" duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 28.07.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, *shpallet jo kompetent për të vendosur* për ankesën me numër A.nr.531/2022 e datës 14.06.2022 të parashtruar nga ankuesi

**A r s y e t i m**

Ankuesi sipas kontratës së punës të datës 05.09.2013 ka qene në pozitë: Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Staf dhe Infrastrukturë në Shërbimin Korrektues të Kosovës - Qendrën/Njësinë e Drejtorisë të Departamentit me afat të caktuar nga data 05.09.2013 deri me datën 05.09.2018, ndaj të cilit Ministria e Drejtësisë me datë 19.10.2016 ka nxjerrë Vendimin me numër protokoll 1239, me të cilin ankuesin e ka pezulluar nga puna me 50% të pagës, duke filluar nga data 18.10.2016, sipas shkresës zyrtare të Prokurorisë Themelore në Prishtinë me numër Nr.Bi.nr.47/2016 të datës 14.10.2016, se ndaj ankuesit kanë filluar hetimet dhe është ngritur aktakuzë me dyshimin se ka kryer vepër penale që ndërlihet me punën dhe detyrat e tij zyrtare të përcaktuar me nenin 422 paragrafi 1 dhe 2.1, 2.2, dhe 2.3 të Kodit Penal.

Për të cilin, Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda me datë 06.05.2020 ka nxjerrë Aktgjykimin me numër PKR.nr.685/16 i datës 06.05.2020 është i plotfuqishëm nga data 30.10.2020, lidhur me lirimin e ankuesit nga aktakuza, dhe ankuesi me datë 23.05.2022 ka parashtruar kërkesën tek Drejtori i Përgjithshëm në Shërbimin Korrektues me numër protokoll 0578, për kompensimin e plotë të pagës nga data 06.05.2018 deri me datë 30.10.2020, duke pretenduar se është shpallur i pa fajshëm sipas Aktgjykimit me numër PKR.nr.685/16 të datës 30.10.2020 deri në përfundimin e procedurës penale, për të cilën çështje ankuesi me datë 31.05.2022 ka pranuar

përgjigje me numër protokoll 578 nga Zëvendës Drejtori i Përgjithshëm-Shërbimin Korrektues të Kosovës, se i është bërë kompensimi i pagës për pjesën e pagës së ndaluar prej 50%, me datë 08.10.2020 me Vendimin me numër protokoll 0882, sipas kërkesës së datës 28.09.2020, duke sqaruar se pozita juaj ka qene me mandat -afat të caktuar dhe e cila ka skaduar me datë 05.09.2018, dhe pagesa është bërë deri në afatin e caktuar të kontratës tuaj të punës, i cili afat ka qenë data 05.09.2018.

Ankuesi i pa knaqur me përgjigjen e datës 31.05.2022 të Zëvendës Drejtorit të Përgjithshëm-Shërbimin Korrektues të Kosovës, me datë 14.06.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 3455/2022, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimet ankimore se kompensimi i pagës së ndaluar prej 50% nuk i është bërë e plotë, duke kërkuar që ti bëhet pagesa nga data 06.05.2018 deri në përfundimin e procedurës penale me datën 30.10.2020, pasi që është shpallur i pa fajshëm sipas Aktgjykimit me numër PKR.nr.685/16 të datës 06.05.2020 Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, i plotfuqishëm nga data 30.10.2020.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 21.06.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesën e ankueses tek Shërbimi Korrektues të Kosovës. Ndërsa Këshilli me datën 29.06.2022, ka pranuar nga Shërbimi Korrektues të Kosovës përgjigjen në kërkesë me numër protokoll:3602/2022, së bashku me shkresat e bashkangjitura të lëndës, dhe provat shtesë të datës 28.07.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave ka administruar këto prova Ankesa e datës 14.06.2022 nr.protokoll 3455/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me numër rendor Anr.531/2022; Përgjigje në kërkesë e datës 31.05.2022 me numër 578; Kërkesë e datës 23.05.2022 me numër protokoll 0578; Vendim nr.1239 i datës 19.10.2016; Aktgjykim PKR.nr.685/16 i datës 06.05.2020 i plotfuqishëm me date 30.10.2020; Kontart e punës e datës 05.09.2013; Përgjigje në Ankesë e datës 29.06.2022 përmes e-mailit zyrtar i protokolluar me nr.3792/2022; Vendim numër protokoll 0882 i datës 08.10.2020; Urdhër obligimi për pagesë e datës 08.10.2020; prova shtesë E-maili i datës 28.07.2022 nga NBNJ në Shërbimin Korrektues të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës konstatoi se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, **nuk është kompetent** për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pasi ka shqyrtuar provat e lëndës ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbime Civile të Kosovës, **nuk ka kompetencë për të shqyrtuar ankesën e datës 14.06.2022 të ankuesit** sepse ankuesi ka themeluar marrëdhënie të punës me afat të caktuar në pozitë: Zëvendës Drejtor i Përgjithshëm për Staf dhe Infrastrukturë, në Shërbimin Korrektues të Kosovës - Qendrën/Njësinë e Drejtorisë të Departamentit, duke filluar nga data 05.09.2013 deri me datën 05.09.2018, në pajtim me kushtet e emërimit të përcaktuara në dispozitat ligjore të nenit 216 paragrafin 2 të Ligjit Nr.04/L-149 për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, ku është përcaktuar se: "2.Shërbimi Korrektues mund të ketë edhe zëvendës drejtorët e Përgjithshëm të cilët emrohen sipas procedurës, kushteve dhe kohëzgjatjes të parapara për Drejtorin e Përgjithshëm", që në rastin konkret ankuesit nuk i është bërë vazhdimi i mandatit, sepse ndaj tij është ngritur aktakuzë, sipas shkresës zyrtare të datës 14.10.2016 të Prokurorisë Themelore në Prishtinë me numër Nr.Bi.nr.47/2016, me dyshimin se ka kryer veprë penale që ndërlihet me punën dhe detyrat e tij zyrtare të përcaktuara me nenin 422 paragrafi 1 dhe 2.1, 2.2, dhe 2.3 të Kodit Penal. Për të



cilën çështje me datë 06.05.2020 Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti për Krime të Rënda, ka nxjerrë Aktgjykimin me numër PKR.nr.685/16, dhe me datë 30.10.2020 është bërë i plotfuqishëm, atëherë kur ankuesit me datës 05.09.2018 i ka skaduar afati i kontratës së punës me afat të caktuar, dhe ankuesi e humb statusin e nëpunësit civil, sic e dëshmon dhe prova e bashkangjitur nga ankuesi dhe Njësia e burimeve Njerezore në Shërbimin Korrektues të datës 29.06.2022, me provën shtesë të emailit të datës 28.07.2022, citoj: ".....se ankuesit i është ndërprerë mardhenja e punës me skadimin e kontratës së punës me datë 05.09.2018, dhe se në bazë të dispozitave ligjore të Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, nuk kemi pasur obligim që të njëjtin ta sistemojmë prandaj nga 05.09.2018 nuk është pjese e shërbimit civil. Kompensimi i pagave i është bërë të njëjtit për periudhën nga pezullimi deri në skadim të kontratës".

Andaj, duke u bazuar në dispozitën ligjore të nenit 6 paragrafit 1 nën paragrafit 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, ku përcaktohet se: " 1. Për mbikëqyrjen e zbatimit të rregullave dhe parimeve të legjislacionit për shërbimin civil, Këshilli ka këto funksione themelore: 1.1. shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për praninë në shërbimin civil", dhe mbi këtë bazë konstaton se në rastin konkret Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës, nuk është kompetent për të vendosur për ankesën e parashtruar nga ankuesi, sepse Këshilli shqyrton dhe merr vendime për ankesat e nëpunësve civil dhe të kandidatëve për praninë në shërbimin civil, dhe ankuesi nga data 05.09.2018, i ka skaduar kontrata e punës me afat të caktuar, i cili nuk ka status të nëpunësit civil për t'ju shqyrtuar ankesa e datës 14.06.2022.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenit 132 paragrafit 2 të Ligjit Nr.05/L-031 Për procedurën e Përgjithshme Administrative, vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalin ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda me numër A.nr.531/2022.

Zyle Millaku GOJNOVCI

Procesmbajtëse

Malsore GASHIBAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Drejtorit të Përgjithshëm të Shërbimit Korrektues të Kosovës;
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Drejtësisë
- Udhëheqësit të Burimeve Njerezore në Shërbimin Korrektues të Kosovës dhe
- Arkivit të KPMShCK-së.